



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

U R D H Ë R

NR. 148, DATË 09. 05.2008

PËR

CAKTIMIN E SHKALLËS SË HIERARKISË NË PROKURORI

Me synim,

- caktimin e shkallës së hierarkisë në organin e Prokurorisë;
- unifikimin e të drejtës dhe detyrimit që ka prokurori më i lartë për të ndihmuar, kontrolluar, urdhëruar, udhëzuar, shfuqizuar ose ndryshuar aktet e prokurorit më të ulët, si dhe;
- forcimin e kontrollit të brendshëm në prokurori.

Në mbështetje, të nenit 118 e vijues të Kushtetutës, të neneve 24 pikat 4 e vijues të K. Pr. Penale, të neneve 8 pika 2, 4 pika 3 paragrafi i dytë dhe vijues të ligjit Nr. 8737, datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10.07.2003,

URDHËROJ:

1. SHKALLA E HIERARKISË NË PROKURORI¹

1. Shkalla e hierarkisë në prokurori përcaktohet sipas niveleve të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë, në drejtimin vertikal ose të centralizuar, nga prokurori më i lartë tek prokurori më i ulët, si më poshtë:

1.1 Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm janë prokurorë më të lartë se prokurorët e Prokurorive të Apeleve dhe të Prokurorive të shkallës së parë.

1.2. Prokurorët e Prokurorive të Apelit, në gjykimet e çështjeve të apeluara që kanë në juridiksion janë prokurorë më të lartë se prokurorët e Prokurorive të shkallës së parë, të cilët i përkasin atij juridiksioni.

1.3. Prokurorët e shkallës së parë, sipas kompetencës lëndore dhe tokësore, janë prokurorë të nivelit të parë në prokurori.

2. Prokurorët, drejtues të drejtorive dhe sektorëve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, drejtues të Prokurorive të apeleve dhe drejtues të Prokurorive të shkallës së parë, janë prokurorë më të lartë se prokurorët në strukturat përkatëse që ata drejtojnë.

¹ Shih, neni 4/3 paragrafi dytë i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R.Sh"

3. Prokurorët më të lartë, sipas niveleve të Prokurorive, krahas kompetencave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj, kanë detyrë:

3.1 Për të analizuar dhe vlerësuar respektimin e parimeve të procedimit të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor në ndjekjen penale, në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë, në ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e ligjshme të njeriut në procesin penal;

3.2 Për të urdhëruar ose udhëzuar me shkrim kryerjen e veprimeve hetimore të domosdoshme për plotësimin e hetimeve paraprake ose për ndryshimin apo plotësimin e kualifikimit ligjor të veprës penale;

3.3 Për të referuar tek prokurori më i lartë (drejtuesi përkatës) ndryshimin ose shfuqizimin e akteve të prokurorit më të ulët në hetimet paraprake, kur ato konstatohen të pabazuar në ligj ose në prova, ashtu dhe të akteve të tjera në rastet kur çmohet se janë të pavlefshëm.

4. Prokurorëve - drejtor dhe shefa sektori - të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të ndihmuar nga prokurorët pranë tyre, sipas grup veprave dhe drejtimeve që mbulojnë, u delegoj kompetencat e prokurorit më të lartë:

4.1 Për të vendosur ndryshimin ose shfuqizimin e akteve të prokurorit më të ulët në hetimet paraprake, si vendime: mosfillimi të procedimit, pezullimi të hetimeve ose pushimi çështje/akuze, ndryshimin e akuzës apo të cilësimit juridik të veprës, kur ato konstatohen të pabazuar në ligj dhe/ose në prova, ashtu dhe të akteve të tjera në rastet kur çmohet se janë të pavlefshëm;

4.2 Për të bërë ankim, brenda afatit ligjor, në rastet kur vlerësohet që çështja duhet ankimuar dhe kjo e drejtë nuk është ushtruar nga drejtuesi i prokurorisë përkatëse ose prokurori i çështjes.

5. Në rastet kur nga ushtrimi i delegimeve të përmendura në **pikën 1-4.1 e 4.2** të këtij urdhri, del se duhet lehtësuar pozita e të pandehurve ose personave nën hetim, prokurorët - drejtor dhe shefa sektori - të kësaj Zyre, para formulimit të aktit përkatës duhet të vënë në dijeni Prokurorin e Përgjithshëm.

II. DREJTIMI DHE KONTROLLI NË PROKURORI

1. Prokuroria në të gjithë nivelet e saj drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ndihmohet nga drejtuesit dhe prokurorët e Zyrës së tij, drejtuesit e Prokurorive të apeleve dhe drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë.

2. Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të përcaktuar në pikën **1.1** të këtij urdhri, sipas grup veprave dhe drejtimeve që mbulojnë, ushtrojnë ndihmë metodike dhe kontroll në prokuroritë e niveleve më të ulëta, ushtrojnë funksione, kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara në Kushtetutë e në ligj, në këtë urdhër ose që u delegohen posaçërisht nga Prokurori i Përgjithshëm. Ata, sipas strukturës së kësaj Zyre dhe drejtimeve që mbulojnë, organizohen, drejtohen dhe kontrollohen nga drejtorët ose shefat e sektorëve të tyre, të cilëve u raportojnë për të gjithë veprimtarinë që kryejnë.

3. Drejtuesit e Prokurorive të Apeleve, të ndihmuar nga zëvendësit e tyre, ushtrojnë funksione organizimi, drejtimi dhe kontrolli në gjykimin e çështjeve të apeluara, përkatësisht në Prokuroritë e Apeleve ku janë të caktuar, si dhe

funksiione të përcaktuara në Kushtetutë e në ligj, në këtë urdhër ose që u delegohen posaçërisht nga Prokurori i Përgjithshëm.

4. Drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë, të ndihmuar nga zëvendësit ose shefat e sektorëve aty ku ka të tillë, ushtrojnë funksione organizimi, drejtimi dhe kontrolli në Prokuroritë e shkallës së parë ku janë të caktuar, si dhe funksione të përcaktuara në Kushtetutë e në ligj, në këtë urdhër ose që u delegohen posaçërisht nga Prokurori i Përgjithshëm.

5. Përfaqësimi i prokurorisë në marrëdhënie me të tretët - institucionet qendrore të shtetit ose me përfaqësuesit e tyre, - kryhet nga Prokurori i Përgjithshëm ose personi që i delegohet kjo kompetencë prej tij.

5.1 Drejtuesit e prokurorive të shkallë të parë dhe të prokurorive të apelit janë personat përgjegjës që komunikojnë zyrtarisht dhe përgjigjen për marrëdhëniet e prokurorisë që drejtojnë me prokuroritë e tjera ose me institucionet vendore në juridiksionin e tyre.

5.2 Sa më sipër, përjashtim bëhet për kryerjen e veprimeve procedurale penale lidhur me çështjet që prokuroria ka në ndjekje penale, veprime të cilët kryhen nga organi procedurës - prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore.

III. NJOHJA, ZBATIMI, KONTROLLI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive të të gjithë niveleve.

2. Për ushtrimin e kompetencave të deleguara me këtë urdhër duhet të informohet Prokurori i Përgjithshëm, jo më vonë se një herë në muaj, nga prokurorët më të lartë në Prokuroritë e shkallës së parë dhe të apeleve, si dhe nga prokurorët - drejtues të kësaj Zyre.

3. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe nga prokurorët dhe drejtuesit e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

5. Pjesa e I-rë e urdhrit nr. 102, datë 23. 03. 2004 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e disa rregullave administrative në ZPP ", si dhe çdo akt normativë në Prokuroritë e të gjithë niveleve që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORII PËRGJITHSHËM
INA RAMA